



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 29 nëntor 2024

Njoftim për shtyp

Zhvillime më të rëndësishme te institucionet tjera financiare¹ (ITJ): tremujori i tretë i vitit 2024

- **Në tremujorin e tretë të vitit 2024, totali i mjeteve të institucioneve të tjera financiare (ITJ) është 242.690 milionë denarë** dhe janë rritur për 7.492 milionë denarë, në nivel tremujor. Ndërkaq, mjetet e institucioneve tjera financiare marrin pjesë me 21,5% në mjetet e institucioneve financiare². Analizuar sipas nënsektorëve, fondet pensionale kanë pjesëmarrje më të madhe prej 65,6% në mjetet totale të ITJ-së prej 65,6% dhe pas tyre vijnë kompanitë e sigurimit me pjesëmarrje prej 15,6%.
- **Totali i mjeteve të institucioneve të tjera financiare (ITJ), këtë tremujor,** shënoi rritje tremujore dhe vjetore prej 3,2%, respektivisht 20,4%, kryesisht si rezultat i rritjes së mjeteve të fondeve pensionale, me zhvillime pozitive edhe te nënsektorët e tjerë.

Tabela 1. Gjithsej mjete / detyrime të ITJ-së, sipas nënsektorëve

	T3.2023	T2.2024	T3.2024	ndryshime tremujore		ndryshime vjetore		Struktura (Totali i IF)	Struktura (Totali i ITF)
				T3. 2024/T2. 2024		T3. 2024/T3. 2023			
				gjendja, në milionë denarë		në milionë denarë në %		në %	në %
1. Institucionet financiare (ITD dhe ITF)	1,030,818	1,103,970	1,128,489	24,519	2.2	97,671	9.5	100.0	0
2. Institucione të tjera depozituese (ITD)	829,210	868,772	885,799	17,027	2.0	56,589	6.8	78.5	0
3. Institucionet të tjera financiare (ITF)	201,608	235,198	242,690	7,492	3.2	41,082	20.4	21.5	100.0
3.1 Fondet pensionale	131,729	153,521	159,240	5,719	3.7	27,511	20.9	14.1	65.6
3.2 Shoqëritë të sigurimeve	34,390	37,105	37,746	641	1.7	3,356	9.8	3.3	15.6
3.3 Fondet e investimeve	12,290	17,954	17,967	13	0.1	5,677	46.2	1.6	7.4
3.4 Shoqëritë financiare	10,642	11,837	12,291	454	3.8	1,649	15.5	1.1	5.1
3.5 Shoqëritë të lizingut financiar	10,208	12,268	12,838	570	4.6	2,630	25.8	1.1	5.3
3.6 Shoqëri administruese të fondeve pensionale dhe investuese	2,348	2,513	2,607	94	3.8	259	11.0	0.2	1.1

Burimi: BPRM-ja.

¹ Në institucione tjera financiare janë të përfshira: fondet e investimit, fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve, kompanitë për menaxhimin me fondet investuese dhe kompanitë për menaxhim me fondet pensionale, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.

² Për nevojat e këtij njoftimi në kategorinë e institucioneve financiare (IF) janë përfshirë: institucionet tjera depozitare (ITD - bankat dhe kursimoret) dhe institucione tjera financiare (ITF).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- **Instrumentet më të rëndësishme në anën e mjeteve të ITJ-së** janë investime në letrat me vlerë të borxhit³ (pjesëmarrje prej 52,1%), si dhe investimet në letra me vlerë të kapitalit (pjesëmarrje prej 26,1%). Shikuar **nga ana e detyrimeve**, pjesa më e madhe i takon rezervave teknike të sigurimit⁴ dhe llogarive të kapitalit (pjesëmarrje prej 54,4%, respektivisht 36,1%⁵).

Tabela 2. Mjete/detyrime të ITJ-së, pas nënsektorëve dhe pas instrumenteve financiare, tremujori i tretë 2024

	Totali i ITF		Fondet pensionale		Shoqëritë të sigurimeve		Fondet e investimeve		Shoqëritë financiare		Shoqëritë të lizingut financiar		Shoqëri administruese të fondeve pensionale dhe investuese	
	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)
TOTALI I MJETEVE	242,690	-	159,240	-	37,746	-	17,967	-	12,291	-	12,838	-	2,607	-
I. Valuta dhe depozitat	16,753	6.9	3,361	2.1	7,435	19.7	4,469	24.9	595	4.8	417	3.2	475	18.2
II. Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	126,557	52.1	104,941	65.9	15,588	41.3	4,421	24.6	-	-	-	-	1,607	61.6
III. Kreditë	20,538	8.5	1	-	211	0.6	-	-	10,538	85.7	9,769	76.1	19	0.7
IV. Aksionet dhe kapitali tjetër	63,396	26.1	50,429	31.7	3,688	9.8	9,062	50.4	29	0.2	-	-	187	7.2
V. Rezervat teknike të sigurimit	2,670	1.1	-	-	2,670	7.1	-	-	-	-	-	-	-	-
VI. Derivative financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
VII. Kërkesa tjera	8,239	3.4	508	0.3	6,408	17.0	14	0.1	752	6.1	422	3.3	135	5.2
VIII. Mjetet jofinanciare	4,537	1.9	-	-	1,746	4.6	-	-	377	3.1	2,230	17.4	184	7.0
TOTALI I DETYRIMEVE	242,690	-	159,240	-	37,746	-	17,967	-	12,291	-	12,838	-	2,607	-
I. Kreditë	15,363	6.3	-	-	99	0.3	-	-	4,961	40.4	10,256	79.9	46	1.8
II. Rezervat teknike të sigurimit	131,955	54.4	108,022	67.8	23,933	63.4	-	-	-	-	-	-	-	-
III. Derivative financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
IV. Kërkesa tjera	7,678	3.2	68	0.0	3,364	8.9	148	0.8	2,730	22.2	1,255	9.8	113	4.3
V. Llogaria kapitale	87,695	36.1	51,150	32.1	10,350	27.4	17,819	99.2	4,600	37.4	1,327	10.3	2,448	93.9

Burimi: BPRM-ja.

- **Analizuar sipas instrumenteve, nga ana e mjeteve**, rritja tremujore është kryesisht nga rritja e investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe të kapitalit me kontribut pozitiv shtesë edhe të kredive, në kushtet e rënies së valutave dhe të depozitave. Rritja vjetore vjen kryesisht nga investimet më të larta në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit dhe në masë më të vogël nga kreditë. **Nga ana e detyrimeve**, rritja në nivel tremujor është më së shumti rezultat i rritjes së rezervave teknike të sigurimit dhe rritjes së llogarive të kapitalit a ndikim pozitiv kanë edhe detyrimet e bazuara në kredi, kur ka rënie të detyrimeve të tjera. Rritja vjetore është kryesisht rezultat i rritjes së llogarive kapitale dhe rezervave të sigurimit teknik, dhe në masë më të vogël edhe detyrimeve të bazuara në kredi.


³ Letrat me vlerë të borxhit (LVB) i referohen letrave me vlerë të ndryshme nga aksionet në pajtim me klasifikimin ndërkombëtar të instrumenteve financiare, siç është publikuar në bilancet dhe pasqyrat e institucioneve tjera financiare.

⁴Rezervat teknike të sigurimit përmbajnë: kapitalin neto të amvisërive në rezervat nga sigurimi i jetës, kapitali neto i amvisërive në fondet pensionale dhe premitë e parapaguara dhe rezervat kundrejt kërkesës për llogarimbajtje (sigurimi jojetë).


⁵Llogaritë kapitale i përfshijnë: investimet pronësore, fitimi i mbajtur, fitimi nga viti aktual, rezerva e përgjithshme dhe e veçantë dhe përshtatjet me vlerë.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës




Burimi: BPRM-ja.



Zhvillime më të rëndësishme të ITJ-të, sipas llojeve të institucioneve

- **Në tremujorin e tretë të 2024, totali i mjeteve të fondeve pensionale⁶ (të detyrueshme dhe vullnetare)** shënoi rritje tremujore dhe vjetore prej 3,7%, përkatësisht 20,9%. Shikuar nga instrumentet, ndryshimi në rritje në të dy bazat, është për shkak të letrave me vlerë më të larta të borxhit dhe kapitalit, me rritje të vogël të kërkesave të tjera dhe në kushtet e rënies së vërejtur të valutës dhe të depozitave. Në anën e detyrimeve, rritja tremujore dhe vjetore tërësisht vjen nga rritja e rezervave teknike dhe të llogarive kapitale.




Burimi: BPRM-ja.

⁶BPRMV aktualisht e njoftojnë të gjitha fondet pensionale që janë të përfshira në regjistrin e Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS), nga të cilat shtatë të detyrueshme dhe katër vullnetare fondet pensionale.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- **Totali i mjeteve të shoqërive të sigurimit⁷**, në tremujorin e tretë u rrit për 1,7% në nivel tremujor, e ndikuar në masë më të madhe nga rritja e valutave dhe depozitave dhe rezervave teknike të sigurimeve, me ndikim pozitiv, por më të vogël edhe të mjeteve jofinanciare, si dhe letrat me vlerë të kapitalit dhe borxhit, ndërsa kërkesat të tjera janë zvogëluar. Në bazë vjetore, mjetet e shoqërive të sigurimit janë më të larta për 9,8%, me kontribut më të madh në rritjen e letrave me vlerë të borxhit dhe kapitalit, valutave dhe depozitave dhe kërkesave të tjera, dhe në masë më të vogël edhe të mjeteve jofinanciare dhe rezervat e teknike të sigurimit. Nga ana e detyrimeve, rritja tremujore dhe vjetore është rezultat i rritjes së rezervave teknike të sigurimit dhe llogarive të kapitalit, ndërsa rënie është realizuar te detyrimet e tjera.



Burimi: BPRM-ja.


- **Totali i mjeteve të fondeve të investimit⁸**, këtë tremujor shënoi rritje të vogël tremujore prej 0,1%, në ndikimin e letrave me vlerë të larta të kapitalit borxhit, në kushtet e uljes së vërejtur te valutat dhe depozita dhe kërkesave të tjera. Rritja vjetore është 46,2% dhe është rezultat i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të kapitalit, valutave dhe depozitave më të larta dhe letrat me vlerë të borxhit. Nga ana e detyrimeve, ndryshimi në baza tremujore vjen si pasojë e rritjes së llogarive kapitale, me rënie të detyrimeve të tjera, ndërsa ndryshimi vjetor vjen kryesisht nga rritja e llogarive kapitale.

⁷BPRMV-në rregullisht e njoftojnë të gjitha gjashtëmbëdhjetë kompanitë e sigurimit që janë të përfshira në regjistrin e Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit (AMS), nga të cilat njëmbëdhjetë për sigurim jojetë dhe pesë për sigurim të jetës.


⁸Në regjistrin e Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV) aktualisht janë përfshirë njëzet e tre fonde investuese të hapura dhe një fond investues privat, me ç'rast në të dhënat janë përfshirë njëzet e katër fonde investuese.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës



- **Në tremujorin e tretë të 2024, totali i mjeteve të shoqërive financiare^{9,10}** shënoi rritje mujore dhe vjetore prej 3,8%, respektivisht 15,5%. E analizuar sipast instrumenteve, pjesa më e madhe nga mjetet e shoqërive financiare janë kërkesa në bazë të kredive, në shumë prej 10.538 milionë denarë, që shënojnë rritje tremujore dhe vjetore prej 4,1%, respektivisht 13,3%. Nga ana e detyrimeve, rritja në nivel tremujor është rezultat i rritjes së llogarive kapitale dhe detyrimeve në bazë të kredive, ndërsa detyrimet e tjera shënuan rënie. Rritja vjetore e detyrimeve kryesisht është rezultat nga rritja e detyrimeve të bazuara në kredi dhe llogari kapitale, me kontribut më të vogël shtesë edhe të detyrimeve tjera.




⁹Në të dhënat aktualisht janë përfshirë tridhjetë e pesë kompani financiare.

¹⁰Në tremujorin e katërt të vitit 2017 në seritë të dhëna është përfshirë kompani financiare e re (kursimore që regjistrohet në kompani financiare), ndryshimi që ka ndikim në normat vjetore të ndryshimit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Norma e rritjes tremujore dhe vjetore e **totalit të mjeteve të shoqërive që ofrojnë lizing financiar**¹¹ janë 4,6%, respektivisht 25,8%. Kreditë e këtij nënsektori si instrumenti kryesor në anën e mjeteve, këtë tremujor janë 9,769 milionë denarë. Rritja e kredisë në baza tremujore është 5,2%, ndërsa në nivel vjetor rritja është 22,7%. Nga ana e detyrimeve, rritja në të dyja bazat shpjegohet me rritjen e detyrimeve të bazuara në kredi dhe në masë më të vogël nga llogaritë e kapitalit dhe detyrimeve të tjera.




Burimi: BPRM-ja.

- Në tremujorin e tretë të 2024, **totali i mjeteve të shoqërive administruese të fondeve të fondeve pensionale dhe investimeve** shënuan rritje tremujore prej 3,8% e ndikuar më së shumti nga rritja e valutave dhe depozitave, letrave me vlerë të borxhit dhe kërkesave të tjera. Në baza vjetore, mjetet e këtij nënsektori u rritën për 11,0%, kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit, me kontribut më të vogël të letrave me vlerë të kapitalit dhe mjeteve jofinanciare. Nga ana e detyrimeve, rritja e tremujorit është reflektim i llogarive më të larta të kapitalit, në kushtet e rënies së detyrimeve të tjera, ndërkohë që rritja vjetore është kryesisht rezultat i rritjes së llogarive kapitale dhe në masë më të vogël të detyrimeve të tjera.

¹¹ Në të dhënat aktualisht janë përfshirë nëntë kompani - ofrues të lizingut financiar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës



Burimi: BPRM-ja.

Rishikimi i të dhënave

Të dhëna për zhvillimin të ITJ-ja në këtë njoftim përmbajnë rishikime të të dhënave nga tremujori i katërt i vitit 2022. Këto rishikime nuk shkaktojnë ndryshime të ndjeshme të të dhënave paraprakisht të publikuara dhe kryesisht rrjedhin nga përfshirja më e mirë dhe cilësia e raportimeve.

Informacione mbështetëse

Seri kohore të të dhënave: Të dhëna tremujore për mjetet dhe detyrimet e institucioneve financiare

<https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-bilans-i-pregledi-na-finansiskite-institucii-kvartalni-podatoci-al.nsp>

Shpjegime metodologjike:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf



**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria e Statistikës**

Publikimet e ardhshme: Kalendar për publikimin e të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna tremujore për mjetet dhe detyrimet e institucioneve financiare: 28 shkurt 2024 (mesatare referuese përfshirë tremujorin e katërt 2024).

Për pyetje gazetarësh, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 113 (ose 108/110).